



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 7 regjistër (JR)
Datë 11.02.2019

Nr. 29 i vendimit
Datë 08.11.2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Luan Daci	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 08.11.2019, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Hans Kijlstra, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 07, datë 11.02.2019, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Fatos Qato, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 87, datë 17.12.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 63 dhe 66, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), me vendimin nr. 87, datë 17.12.2018, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Fatos Qato, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Komisioni arriti në këtë përfundim pasi administroi tri raportet e vlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim "ILDKPKI") në bazë të neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim "DSIK") në bazë të neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016 dhe nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim "KLD") në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, kreu hetimin administrativ dhe vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Fatos Qato vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pa vendosur mbi kriterin e kontrollit të figurës dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.
3. Trupi gjykues i Komisionit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, zhvilloi seancën dëgjimore publike, mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit Fatos Qato arriti në përfundim se:
 - 3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:
 - i. *Nuk ka deklaruar saktë pagesën e këstit të katërt të çmimit të blerjes së apartamentit, me sipërfaqe 141 m², si dhe vlerëson se:*
 - a. *shpjegimet e tij për justifikimin e pagesave për këstet nuk janë bindëse, pasi subjekti nuk ka përllogaritur/përfshirë shpenzimet jetike të familjes në bashkëjetesë me prindërit e bashkëshortes;*
 - b. *subjekti është në pamundësi financiare që me të ardhurat e realizuara sipas pretendimeve të tij, të paguajë këstet për blerjen e apartamentit dhe të përballojë shpenzimet e jetesës të familjes me disa anëtarë.*
 - ii. *Nuk ka deklaruar në deklaratat periodike shpenzimet e arredimit, kurimit të tij shëndetësor, shkollimit të fëmijëve.*
 - iii. *Mosdeklarimi i shpenzimeve në deklaratat periodike të pasurisë, ka ardhur si pasojë e mungesës së të ardhurave të ligjshme ndër vite dhe për rrjedhojë edhe deklarimi i të ardhurave në deklaratën vetting nuk është i saktë.*
 - iv. *Subjekti ka mungesë të burimeve financiare, ndër vite, në vlerën 5.414.393 lekë, për të justifikuar blerjen e pasurisë "tokë arë", blerjen e automjetit tip "Volswagen Polo", blerjen e automjetit tip "Renault", si dhe për të përballuar shpenzime mjekësore, të arredimit, të shkollimit të fëmijëve, të udhëtimeve, si dhe shpenzimet jetike të familjes së tij.*
 - v. *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka dhënë shpjegime bindëse lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, referuar pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
4. Në përfundim të procesit të rivlerësimit vetëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, Komisioni

vendosi që subjektit të rivlerësimit Fatos Qato t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", si dhe në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

I. Shkaqet procedurale të ankimit

Në parashtrimet e tij, subjekti i rivlerësimit pretendon sa më poshtë.

5. Vendimmarrja e Komisionit për të përfunduar hetimin administrativ vetëm për një kriter vlerësimi, atë të pasurisë, nuk gjen mbështetje në përcaktimet e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit mund të shkarkohet me plotësimin e njëkohshëm të 2 (dy) kriterëve, të kriterit të pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe të kriterit të vlerësimit të pasurisë, kërkesë e cila nuk është verifikuar në rastin e subjektit të rivlerësimit Fatos Qato.
6. Në kuptim të shkaqeve kushtetuese për shkarkim, konkluzioni përfundimtar i Komisionit duhet të dilte nga sjellja e subjektit, motivet apo qëllimet e tij në mënyrën e përpilimit të deklaratës së re [deklaratës *vetting*] dhe të dhënave të hedhura në të, pasi deklaratimet periodike duhet t'u shërbejnë organeve të rivlerësimit për të analizuar vlerën e kësaj prove në raport me provat e tjera.
7. Komisioni ka zbatuar e interpretuar gabim nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë që disponon, nuk përmbushet kushti ligjor i "deklarimit të më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme", rrethanë e cila do të përbënte shkak të ligjshëm, sipas nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra.
8. Së bashku me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të administrohen në cilësinë e provës:
 - i. shkresa nr. {***} prot., datë 23.01.2019, e DSIK-së, përmes së cilës i është dërguar subjektit të rivlerësimit "Raporti për kontrollin e figurës", me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 23.03.2018, të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar;
 - ii. shkresa nr. {***} prot., datë 25.01.2019, e Këshillit të Lartë Gjyqësor, përmes së cilës i është vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit "Raporti për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Fatos Qato, për periudhën 08.10.2013 - 08.10.2016".

II. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

II/1 Për pasurinë "apartament banimi me sipërfaqe 141 m², ndodhur në rr. "{***}", p. {***}, ap. {***}, Tiranë", subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit në vendim, sipas të cilit: *Nuk rezultonte që në këto deklarime të ishte përcaktuar se për blerjen e kësaj pasurie kishin*

shërbyer si burim krijimi edhe të ardhurat e prindërve të bashkëshortes [...], për arsyet e mëposhtme.

i. Lidhur me burimin e ligjshëm të përdorur për blerjen e apartamentit, subjekti i rivlerësimit pretendon të ketë deklaruar gjatë hetimit administrativ se burimet e përdorura për blerjen e apartamentit ishin të ardhurat nga pagat dhe kursimet familjare, si dhe ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes me të cilët bashkëjetonte dhe në atë periudhë i kishin lëshuar me qira vilën e ndodhur në rr. "{***}", nr. {***}, fondacionit gjerman {***}, Tiranë.

ii. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit në vendim se në deklaratimet periodike dhe në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar si burime për krijimin e kësaj pasurie "të ardhurat" dhe "kursimet e familjes në vite", por jo "të ardhurat e prindërve të bashkëshortes". Lidhur me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendon të ketë deklaruar dhe argumentuar në deklaratimin e bërë në vitin 2003 se burimet e ligjshme të përdorura për blerjen e apartamentit 141 m² kanë qenë "të ardhurat", ndërsa në deklaratimet e viteve të tjera në vijim: "kursimet e familjes ndër vite", "ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes", si dhe "të ardhurat nga dhënia me qira e banesës së prindërve të bashkëshortes".

iii. Me termat "të ardhura" dhe "kursimet familjare ndër vite", referuar ankimit, subjekti i rivlerësimit ka nënkuptuar të gjitha të ardhurat familjare, përfshirë edhe pensionin e prindërve të bashkëshortes, duke qenë se ata jetonin së bashku.

9. Nisur nga konkluzioni i Komisionit se *subjekti nuk depozitoi dokumentacion për të provuar të ardhurat e përfituara nga prindërit e bashkëshortes për shkak të dhënies së vilës me qira fondacionit gjerman {***}, që përbënin të ardhura relativisht të larta¹, nga subjekti u paraqit vërtetimi nga instituti "{***}" me nr. {***} prot., datë 05.12.2018, në bazë të të cilit ai pretendon se janë përfitur 1200 USD/muaj për qiranë e vilës së ndodhur në rr. "{***}", nr. {***}, Tiranë nga prindërit e bashkëshortes, për të gjithë periudhën 1996-1998.*

10. Subjekti kundërshton vendimin e Komisionit lidhur me pagesat e kësteve të çmimit kontraktor në vlerën 28.200 USD, muajin/vitin sipas kushteve kontraktuale të sipërmarrjes, nënshkruar me shoqërinë "{***}" ShPK, më datë 05.02.1997, si dhe faktin që nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për justifikimin e blerjes së kësaj pasurie, me arsyetimin e mëposhtëm.

i. Blerja e apartamentit sipas subjektit provohet me dokumentacion ligjor bazë, që është kontrata e porosisë individuale e datës 05.02.1997, kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2017, me shoqërinë "{***}" ShPK, si dhe me mandatarkëtimet nr. {***}, datë 15.01.1997 dhe nr. {***}, datë 08.12.1997.

ii. Gjithashtu subjekti pretendon se nuk ka kryer fshehje të pronës, pasi apartamenti në fjalë

¹ Sipas përllogaritjeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit në ankim, totali i të ardhurave të pretenduara se janë përfitur prej vjehrrës së subjektit nga dhënia me qira e vilës në rr. "{***}", nr. {***}, Tiranë, ka qenë në vlerën 43.200 USD ose 5.818.608 lekë.

është deklaruar që në “Deklaratën e parë të interesave privatë periodikë vjetorë” (në vijim “deklarata e interesave privatë”) për vitin 2003.

iii. ILDKPKI-ja e ka raportuar deklarimin e subjektit të rivlerësimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar.

iv. Lidhur me konstatimin e Komisionit se *nuk janë deklaruar saktë data/muaji/viti se kur janë paguar 2 (dy) këstet e fundit për blerjen e apartamentit*, sipas subjektit të rivlerësimit në ankim, mandatpagesat për to kanë humbur, pasi bëhet fjalë për një periudhë 21-vjeçare, dhe subjekti pretendon të mos ketë pasur detyrim ligjor për t'i ruajtur dokumentet justifikuese të sipërcituara.

v. Për pagesën e këstit të katërt prej 2820 USD, subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se kjo pagesë nuk është kryer, dhe nga kompania sipërmarrëse është pranuar si kompensim financiar për këstin e katërt vlera e materialeve të blera dhe e punimeve të kryera nga vetë subjekti i rivlerësimit në apartament.

11. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit në vendim, sipas të cilit *kostot për punime ekstra duhet t'i shtoheshin analizës financiare, në të kundërt çmimi i likuiduar i blerjes së apartamentit në kontratën e shitblerjes, në vlerën prej 28.200 USD, rezulton fiktiv*. Sipas subjektit, kësti i katërt prej 2820 USD, përfaqëson pikërisht një pjesë të vlerës së punimeve të rifiniturës, të cilat janë përballuar nga vetë subjekti dhe materialet e rifiniturës janë blerë prej tij për llogari të firmës ndërtuese, e cila kishte detyrimin ligjor t'i kryente këto punime. Për këtë arsye, pagesat e kryera nga subjekti për blerjen e materialeve, janë pranuar nga shoqëria ndërtuese si shlyerje e këstit të katërt, duke u bërë kompensim financiar i vlerës së materialeve me vlerën e shlyerjes së këstit të katërt. Këto, thekson subjekti, nuk janë punime ekstra që i shtohen vlerës së apartamentit, ndërkohë edhe vetë çmimi i blerjes së apartamentit nuk është fiktiv, por është çmimi real, duke qenë se vlera e blerjes së apartamentit, si rezultat i punimeve të rifiniturës, nuk ndryshon.
12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit, si dhe për të përballuar shpenzimet jetike për arsyet e mëposhtme.
 - i. Analiza e kryer nga Komisioni sipas tabelës nr. 3 të vendimit për periudhën 1983-1998, nuk është përfshirë në relacionin përfundimtar që i është komunikuar subjektit para seancës dëgjimore dhe në vend të saj është paraqitur analizë për periudhën 1983-1997, me një rezultat negativ në vlerën 266.787 lekë, ndërkohë që nga subjekti është kundërshtuar në seancë ky rezultat, i cili në fakt është pozitiv në vlerën 630.885 lekë.
 - ii. Në llogaritjet e bëra sipas tabelës nr. 3 të vendimit, Komisioni nuk ka përfshirë të ardhurat nga qiraja e prindërve të bashkëshortes për vitet 1996-1998, sipas vërtetimit nga instituti “{***}”, me nr. {***}, datë 05.12.2018, të pranuar edhe në paragrafin 1.2.8 të vendimit të Komisionit, që në total janë në vlerën 5.818.608 lekë.
 - iii. Komisioni ka gabuar kur ka përllogaritur me kurs këmbimi valutor 140,68 ALL/USD për

të konvertuar për vitin 1998 edhe shumën 11.280 USD, të kështit të tretë e të katërt së bashku të çmimit të apartamentit 141 m², pasi këmbimi nga lekë në dollarë amerikanë nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është bërë në vitin 1998, por gjatë viteve 1995 dhe 1996, kur kursi ka qenë më i ulët në treg. Në këtë kuptim, Komisioni duhet të kishte përdorur kursin valutor të këmbimit që ka përdorur për vitin 1997, pra 1 USD = 95,74 ALL, e për pasojë 11.280 USD x 95,74 ALL/USD = 1.079.947 ALL (lekë).

iv. Duke bërë përllogaritjet në saktësim të tabelës nr. 3 të vendimit të Komisionit, sipas argumenteve më sipër, rezultati financiar paraqitet pozitiv në shumën 6.141.160 lekë.

v. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë asnjë të ardhur të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, të realizuar për periudhën 1999-2002, ku sipas dokumentacionit ligjor të ndodhur në dosje, rezulton se për këtë periudhë të ardhurat në total janë në vlerën 4.271.452 lekë dhe shpenzimet për arredim janë në vlerën 1.400.000 lekë, ndërsa teprica pozitive është në shumën 2.871.452 lekë, pa përfshirë shpenzimet jetike për të cilat mungon informacioni për periudhën përkatëse, tepricë e cila, sipas subjektit, duhet të merret në konsideratë në llogaritjet e bëra në analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016.

II/2. Shkaqe të tjera ankimi për kriterin e vlerësimit të pasurisë

13. Lidhur me analizën e situatës financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2016 të kryer nga Komisioni dhe të paraqitur në tabelën nr. 5 të vendimit, subjekti ka parashtruar pretendimet dhe shpjegimet në vijim.

i. Shpenzimet për arredim nuk janë kryer sipas përllogaritjeve të Komisionit në tabelën nr. 5 të vendimit, që i shpërndan këto shpenzime në vetëm 6 (gjashtë) vite (2006, 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2012), pasi shpenzimet për arredim janë kryer gjatë 28 viteve, që nga dita e martesës e deri aktualisht, ndërkohë që sipas Komisionit rezulton që subjekti të mos ketë kryer asnjë shpenzim për këtë qëllim, gjatë gjithë periudhës 1990-2006.

ii. Sipas subjektit të rivlerësimit, pyetja që i është bërë nga Komisioni në pyetëtorin standard se sa ka qenë vlera e arredimit të shtëpisë/ve të tij, nuk ka përcaktuar caqe kohore për momentin se kur janë kryer shpenzimet për arredim. Në këtë kuptim, Komisionit i është dhënë përgjigjja nga subjekti i rivlerësimit se shpenzimet e arredimit kanë qenë në total në vlerën 25.000 euro, duke nënkuptuar kryerjen e këtyre shpenzimeve gjatë gjithë periudhës së martesës. Ndërkohë që në përgjigje të pyetjes së bërë në vazhdim nga Komisioni në të njëjtin pyetëtor, ku i kërkohet të specifikojë natyrën dhe kostot e çdo rinovimi, të orendive, dekorimeve dhe pajisjeve elektrike me vlerë më të madhe se 2500 euro në 5 vitet e fundit, është deklaruar nga subjekti blerja e këndit të ndenjjes, financuar nga prindërit e bashkëshortes, me të cilët bashkëjtonin, në vlerën 5000 euro.

14. Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën financiare të kryer në Komision edhe pasi ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit për përfshirjen e të ardhurave të vjehrrit dhe të vjehrrës, nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të

ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë “tokë arë”, si dhe për të përballuar shpenzimet e kryera në vitin 2012. Sipas tabelës së paraqitur nga subjekti në ankim, teprica pozitive monetare e akumuluar nga vitet e mëparshme rezulton në shumën 1.892.221 lekë për vitin 2011 (që përbën shumën e tepricave monetare të çdo viti të periudhës 2003-2011), dhe po t'i zbritet kësaj teprice rezultati negativ i vitit 2012 në vlerën 1.871.408 lekë, rezulton diferenca pozitive progresive për shumën 20.813 lekë deri në datën 31.12.2012.

15. Lidhur me konkluzionin e Komisionit në vendim se nga rezultatet e analizës financiare të kryer, [...] pasi u morën në konsideratë pretendimet e subjektit [...], rezultoi se [...] subjekti i rivlerësimit nuk ka të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë, si dhe për të mbuluar shpenzimet e tij dhe të familjes ndër vite [...], pasi ka gjendje negative për vitet: 2005, 2007, 2008, 2010, 2011, 2012 dhe 2014 në vlerën totale 5.414.393 lekë. Subjekti i rivlerësimit në ankim ngre pretendimin se Komisionit i rezulton gjendje negative, pasi nuk merr në konsideratë tepricat monetare pozitive që akumulohen dhe mbarten vit pas viti, duke filluar prej vitit 2003 deri më 31.12.2016, ndërkohë që llogaritjet i ka kryer duke akumuluar dhe mbartur vetëm vlerat negative dhe kjo, sipas subjektit, nuk ka kuptim ekonomik.
16. Konkluzioni i Komisionit në vendim se subjekti i rivlerësimit nuk provoi dhënien e shumës 5000 euro nga prindërit e bashkëshortes, si dhe nuk provoi burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar, nuk qëndron, pasi subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se prindërit e bashkëshortes kanë bashkëjetuar gjatë gjithë kohës me familjen e subjektit nën një ekonomi të përbashkët dhe të ardhurat e tyre nga pensionet përkatëse janë të ardhura të ligjshme.
17. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit lidhur me mosdeklarimin e shpenzimeve mjekësore në vlerën 6.500 euro për kurim në Gjermani përgjatë vitit 2012, si dhe për blerjen e këndit të ndenjjes në vlerën 5000 euro në vitin 2016, në deklaratat e interesave private të viteve 2012 dhe 2016 përkatësisht, si dhe në deklaratën vetting 2017.
18. Subjekti i rivlerësimit e gjen të gabuar konstatimin e Komisionit në vendim se nga analiza financiare e kryer për vitet 2014 dhe 2015, të paraqitur në tabelën nr. 5 të vendimit, ka rezultuar të ketë pasur mungesë të burimeve financiare për të kryer shpenzimet e shkollimit të fëmijëve për vitet 2014-2015, të cilat nuk i ka deklaruar në deklaratat e interesave private për vitet përkatëse, pasi, sipas subjektit, nëse i referohemi analizës financiare të kryer për periudhën 2003-2016, të saktësuar prej tij dhe të pasqyruar në tabelën nr. 5 në ankim, ku janë konsideruar shpenzimet e sipërpërmendura, rezulton se çdo vit ka pasur tepricë pozitive monetare, përfshirë vitet 2014 dhe 2015.

III. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me shkaqet procedurale të ankimit

19. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se hetimi i Komisionit vetëm për kriterin e pasurisë është në shkelje të Kushtetutës, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit për të proceduar vetëm me gjykimin e një kriteri është në përputhje me nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës,

që parashikon se: “Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi” dhe me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili shpreh qartë se: "Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave". Në bazë të këtij parashikimi ligjor, me të drejtë Komisioni ka filluar hetimin administrativ për të tria kriteret e vlerësimit dhe, pasi ka vlerësuar se e ka hetuar në mënyrë të plotë kriterin e pasurisë, bazuar në provat e grumbulluara dhe vlerën e tyre provuese, ka arritur në përfundimin se vlerësimi i subjektit të rivlerësimit mund të bëhet edhe vetëm për këtë kriter, pa qenë nevoja e përfundimit të hetimit të plotë edhe të dy kritereve të tjera, bazuar kjo edhe në jurisprudencën e Kolegjit². Neni 59 i ligjit nr. 84/2016, në pikën 1 parashikon se për konfirmimin në detyrë duhet që subjekti të rezultojë se përmbush të tria kriteret dhe, si i tillë, arrin të ketë në mënyrë kumulative nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Fakti që neni 59 i ligjit nr. 84/2016, me qëllim konfirmimin në detyrë, kërkon domosdoshmërisht vlerësimin pozitiv të të tria kritereve së bashku, nuk ndalon Komisionin që në rastet kur rezulton se nga hetimet e kryera, për një apo dy kritere, një subjekt nuk arrin një nivel të besueshëm, të mund të përfundojë rivlerësimin duke e bazuar edhe në një kriter.

20. Trupi gjykues nuk gjen të drejtë pretendimin e ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit, sipas të cilit *Komisioni duhet të vendosë mbi bazën e sjelljes së subjektit, motiveve apo qëllimeve të tij në mënyrën e përpilimit të deklaratës së re dhe të dhënave të hedhura në të, pasi deklaratimet periodike duhet t'u shërbejnë organeve të rivlerësimit për të analizuar vlerën e kësaj prove në raport me provat e tjera për të përcaktuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë*. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Kushtetuta nuk ka parashikuar në asnjë moment vlerën primare të deklaratës së pasurisë (*vetting*) apo të deklaratimeve të interesave private periodikë vjetorë. Nga interpretimi sistematik i dispozitave kushtetuese, rezulton se qëllimi i tyre nuk është të përcaktojnë rëndësinë parësore apo dytësore të deklaratimeve, por verifikimi i saktësisë dhe plotësisë së deklaratimeve të subjektit, verifikimi i tejkalimit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, si dhe i burimeve të ligjshme të pasurisë, duke u dhënë të gjitha deklaratimeve vlerën e caktuar të provës, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Deklarata e re e plotësuar nga subjekti i rivlerësimit për efekt të procesit të rivlerësimit, shërben si pikënisje e këtij procesi dhe deklaratimet e tij ballafaqohen me të dhënat e mbledhura nga organet e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të neneve 45-52 të ligjit nr. 84/2016. Kontrolli i deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme shërben për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit apo mjaftueshmërinë e

² Shih vendimin nr. 6/2018(JR) - http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/10/Vendim-Perfundimtar_B-N_-i-anonimizuar-pdf.pdf, nr. 1/2019(JR) - <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/12/Vendimi-A-Licaj-i-anonimizuar.pdf>, nr. 15/2019 (JR) - <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-SR-Dritan-Rreshka-i-anonimizuar-per-publikim.pdf>, nr. 23/2019 etj.

deklarimeve të tij. Referuar jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, është vlerësuar se hetimi dhe vlerësimi i pasurisë së subjekteve të rivlerësimit materializohet përveç të tjerave edhe në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit në deklaratat e interesave privatë dhe në deklaratën e rivlerësimit³.

21. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim se Komisioni ka zbatuar e interpretuar gabim nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi në kushtet kur subjekti ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë që disponon, nuk përmbushet kushti ligjor i "deklarimit të më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme", që sipas nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 do të përbënte shkak të ligjshëm për shkarkimin e tij nga detyra, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit është shkarkuar nga detyra në përputhje dhe në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit jepet në rastin kur rezulton se ai ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dhe jo në përputhje apo në kuptim të nenit 61, pika 1 e këtij ligji. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i pabazuar.
22. Lidhur me aktet bashkëlidhur ankimit nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se këto shkresa nuk mund të merren në cilësinë e provës, pasi, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj, dispozitë kjo e detyrueshme për zbatim, në referim të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në vijim të arsytimit, bazuar në nenin 49, pika 6, germa "a" e ligjit nr. 84/2016, kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Kolegji i Apelit, nëse marrja e provës duket se është e panevojshme për shqyrtimin e çështjes në Kolegji.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit për shkaqet e ankimit që i përkasin kriterit të vlerësimit të pasurisë

Subjekti i rivlerësimit Fatos Qato është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" (në vijim "ligji nr. 9049") i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (në vijim "ligji nr. 9367") i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë, duke filluar nga viti 2003 deri në vitin 2016. Referuar ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar më datë 27.01.2017 "Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *vetting*".

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri, të ardhur apo shpenzim të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, është konstatuar: *Deklarimi është i saktë, ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, nuk ka kryer*

³ Për më tepër shih paragrafët 22-26 të vendimit nr. 5, datë 18.02.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, publikuar në adresën: http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-i-anonimizuar_A_Cama.pdf

fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë, subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Nisur nga aktet që janë administruar në dosje, si dhe shkaqet në ankim të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenet 30 e vijuese të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues në Kolegj ka shqyrtuar çështjen për kontrollin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, personin e lidhur me të dhe personat e tjerë të lidhur, në përputhje me kriteret që parashikojnë dispozitat e mësipërme.

IV/1. Lidhur me pasurinë “apartament me sipërfaqe 141 m², ndodhur në rr. “{***}”, p. {***}, ap. {***}, Tiranë”

23. Komisioni për këtë pasuri ka arritur në përfundimin se:

i. Referuar rezultateve të hetimit administrativ kryesisht, subjekti i rivlerësimit dukej se kish bërë deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, për këtë fakt subjektit i kaloi barra e provës në lidhje me datën/muajin/vitin se kur janë paguar 2 këstet e fundit (i treti dhe i katërti) për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 141 m², ndërsa edhe pas rilogaritjeve, në konsideratë të pretendimit të subjektit për përfshirjen e të ardhurave të vjehrrës dhe vjehrrit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta, lidhur me kohën dhe çmimin e paguar për këstin e katërt, si dhe nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar pasurinë apartament, me sip. 141 m², dhe për të kryer shpenzimet jetike për familjen në momentin e bashkëjetesës me prindërit e bashkëshortes me 4 dhe më vonë me 6 anëtarë.

ii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, referuar paragrafit 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

23.1 Për pasurinë më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (në vijim “ZVRPP”) Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.02.2018, konfirmon pronësinë e Fatos dhe M.Q. mbi këtë apartament.

23.2 Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë për vitin 2003: "Shtëpi banimi e paregjistruar. Vlera 2.700.000 lekë, ndodhur në rr. “{***}”, Nr. P. {***}, Tiranë. Burimi: Të ardhurat. Pjesa që zotëron: 50%". Në “Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *vetting*” 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: "Apartament me sipërfaqe 141 m², ndodhur në rr. “{***}”, pall. {***}, ap. {***}, Tiranë, fituar me kontratën e porosisë individuale të datës 05.02.1997, me çmim 28.200 USD. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Blerë me kursimet e familjes ndër vite”.

23.3 Sipas kontratës së sipërmarrjes, më datë 09.01.1997, me palë investitore Gjykatën e Apelit Tiranë, e përfaqësuar në atë kohë nga subjekti i rivlerësimit Fatos Qato, investitori kishte ngarkuar sipërmarrësin, shoqërinë “{***}” ShPK, për ndërtimin e një godine 6-katëshe me 18 apartamente, në rr. “{***}”, Tiranë, kundrejt një çmimi të përcaktuar (434.000 USD) brenda një afati 15-mujor,

duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës së sipërcituar.

23.4 Sipas kontratës së porosisë individuale mes subjektit të rivlerësimit Fatos Qato dhe shoqërisë "{***}" ShPK, të datës 05.02.1997, rezulton se çmimi i këtij apartamenti duhet të paguhej në 4 këste, konkretisht:

1. kësti i parë në vlerën 846.000 lekë, në datën 20.01.1997;
2. kësti i dytë në vlerën 8460 USD, me arritjen e punimeve në katin e katërt;
3. kësti i tretë në vlerën 8460 USD, me fillimin e punimeve të rifiniturës; dhe
4. kësti i fundit në vlerën 2820 USD, me dorëzimin e objektit përfundimisht me çelësa në dorë.

23.5 *Lidhur me pagesën e kësteve sipas kontratës së nënshkruar mes palëve, nga subjekti i rivlerësimit nuk u paraqitën prova për pagesën e kështit të tretë dhe të kështit të katërt, duke qenë se për kështin e tretë subjekti ka deklaruar që e kishte humbur mandatpagesën, ndërkohë që për kështin e katërt është shprehur gjatë seancës dëgjimore në Komision se nuk e kishte paguar, pasi kishte kryer vetë disa punime shtesë në apartament për shkak se punimet e ndërtuesit nuk ishin në cilësinë e duhur.*

23.6 *Subjekti i rivlerësimit kundërshton arsyetimin e Komisionit në vendim se kostot për punimet shtesë duhet t'i shtoheshin analizës financiare, pasi në të kundërt çmimi i likuiduar i blerjes së apartamentit, në vlerën prej 28.200 USD, është fiktiv, duke pretenduar se nuk ka kosto për punime ekstra që i shtohen vlerës së apartamentit, por kompensim financiar për pagesat e kryera prej tij për blerjen e materialeve për punimet e rifiniturës për llogari të firmës "{***}" ShPK. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues shqyrtoi përmbajtjen e kontratës së shitjes përfundimtare nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 25.01.2017, sipas së cilës: "Palët kontraktore deklarojnë bazuar në kontratat e sipërmarrjes dhe të porosisë se çmimi kontraktor i vendosur prej tyre në vitin 1999 është 28.200 USD dhe likuidimi i tij është bërë sipas të gjitha kushteve të përcaktuara në atë kohë midis palëve dhe sot palët deklarojnë se nuk i detyrohen financiarisht njëri-tjetrit dhe se çmimi kontraktor quhet i likuiduar". Nga analizimi i kontratës së mësipërme, trupit gjykues në Kolegj i rezulton se palët nuk i detyrohen më njëra-tjetrës dhe e kanë likuiduar totalisht çmimin e përcaktuar në kontratë prej 28.200 USD. Gjithashtu, çmimi në kontratën përfundimtare të shitjes është i njëjtë me çmimin e parashikuar në kontratën e porosisë individuale të datës 05.02.1997, çka tregon se subjekti nuk arriti të provonte pretendimin e tij se nuk e ka paguar kështin e katërt.*

Nisur nga fakti që kontrata e sipërmarrjes e datës 09.01.1997, me palë investitore Gjykatën e Apelit Tiranë dhe sipërmarrës shoqërinë "{***}" ShPK, parashikonte se përfundimi i punimeve do të bëhej brenda 15 muajve nga nënshkrimi i kontratës, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti në Komision dokumentacion provues lidhur me përfundimin e këtyre punimeve dhe për pagesën e kështit të tretë dhe të kështit të katërt për likuidimin e çmimit të apartamentit, referuar faktit që në kontratën përfundimtare të shitjes parashikohet se çmimi është likuiduar plotësisht sipas parashikimeve në kontratën respektive të porosisë individuale, trupi gjykues vlerëson se

pagesa e kështit të tretë dhe e kështit të katërt duhet të përfshihet në përlogaritjet e analizës financiare të kryer për vitin 1998.

23.7 Lidhur me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se si burim për këtë blerje, veç të ardhurave të tij dhe të bashkëshortes, kanë shërbyer edhe të ardhurat e prindërve të personit të lidhur, bashkëshortes, të cilët kanë jetuar së bashku me familjen e subjektit. Referuar paragrafit 1.16 të vendimit, Komisioni ka marrë në konsideratë në të ardhurat si të ligjshme, të ardhurat nga pensionet e vjehrrës dhe vjehrrit të subjektit të rivlerësimit, duke i përfshirë ato në analizën financiare përkatëse.

Ndërkohë, lidhur me të ardhurat e pretenduara në ankim si të përfituara nga prindërit e bashkëshortes së subjektit nga dhënia me qira e vilës⁴ për vitet 1996-1997-1998, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë për vitin 2003 si burim të krijimit të pasurisë “apartament me sipërfaqe 141 m²”: “Të ardhurat”, ndërsa në deklaratën *vetting* 2017 ka deklaruar: “Blerë me kursimet e familjes ndër vite”. Ndërsa, në parashtresë/shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes që bashkëjetonin me ne”, të cilët “[...] në atë periudhë [...] i kishin lëshuar me qira vilën në rr. “{***}”, nr. {***}, fondacionit gjerman {***}”. Në vërtetimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me nr. {***} prot., datë 05.12.2018, të lëshuar nga instituti i arsimit “{***}”, Tiranë, dokumentohet e ardhura nga qiraja në vlerën 1200 USD/muaj për nënën e bashkëshortes, V.Sh., nga përdorimi i objektit (shih poshtëshënimin nr. 4) si banesë për “Program Menaxherin e projektit D.L.”.

Nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren mospërputhje lidhur me subjektin që ka marrë me qira vilën në rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë, që rezulton të jetë i ndryshëm në vërtetimin e lëshuar nga instituti i arsimit “{***}” nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij për rezultatet e hetimit administrativ.

Nisur nga fakti që nëpërmjet vërtetimit nr. {***} prot., datë 05.12.2018 subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë të ardhura të pretenduara të fituara nga një periudhë kohore mbi 20 vite më parë, trupi gjykues i Kolegjit nuk krijoi bindjen për vërtetësinë e përfitimit të këtyre të ardhurave, në kushtet kur këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratën e interesave privatë për vitin 2003 si burim krijimi të pasurisë së paluajtshme “apartament me sipërfaqe 141 m²”.

Trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se të ardhurat nga qiraja nuk mund të merren në konsideratë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare, pasi subjekti i rivlerësimit nuk përmbushi detyrimin ligjor në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të provonte me dokumentacion përfitimin e të ardhurave nga qiraja nga prindërit e bashkëshortes dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, në zbatim të nenit 2 të ligjit nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale” i ndryshuar.

⁴ Objekt i regjistruar në regjistrin hipotekor nr. {***}, me nr. {***}, datë 22.11.1995, referuar vërtetimit nr. {***} prot., datë 05.12.2018, lëshuar nga instituti i arsimit “{***}”, Tiranë (vila në rr. “{***}”, nr. {***}).

23.8 *Për pretendimin e ngritur në ankim lidhur me kursin e këmbimit USD/ALL, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit Fatos Qato e ka bërë këmbimin e lekëve në dollarë amerikanë gjatë viteve 1995 dhe 1996, kur kursi ka qenë më i favorshëm për të dhe jo në vitin 1998 kur është bërë përlllogaritja për efekt të analizës financiare të kryer nga Komisioni, trupi gjykues në Kolegj vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion ligjor për të provuar këmbimin e kursimeve të tij deri në vitin 1995 e më tej, në vitin 1996, nga lekë në dollarë amerikanë. Duke qenë se Komisioni e ka përlllogaritur faktikisht këstin e dytë në vlerën 8460 USD, të paguar në vitin 1997, me kursin e këmbimit 95,74 ALL/USD⁵, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 1997 është e drejtë. Nisur nga fakti se subjekti nuk ka provuar me dokumentacion këmbimin e lekëve në dollarë amerikanë në vitin 1995 dhe/apo në vitin 1996, si dhe duke qenë se nuk u provua momenti i pagesës së këstit të tretë dhe të këstit të katërt, përlllogaritja e kursit të këmbimit për këstet e pagesës së çmimit të apartamentit në analizën financiare duhet të bëhet sipas kursit zyrtar mesatar lekë/dollarë amerikanë (ALL/USD) të vitit 1998, duke marrë në konsideratë vlerësimet e bëra më lart në lidhje me afatin e përfundimit të punimeve dhe pagesës së kësteve.*

23.9 *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka bërë një analizë të plotë të situatës financiare për të gjithë periudhën 1983-2016, pasi nuk ka marrë fare në analizë situatën financiare për periudhën 1999-2002, periudhë në të cilën subjekti ka realizuar kursime, pasi nuk ka bërë asnjë investim në blerje prone, përveç shpenzimeve për arredim shtëpie dhe shpenzimeve jetike. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni me të drejtë nuk i ka marrë në konsideratë kursimet e mundshme të pretenduara më sipër për periudhën 1999-2002, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në deklaratën e parë të interesave privatë për vitin 2003. Në kushtet e mosdeklarimit të kursimit, konsiderohet që të gjitha të ardhurat e realizuara deri më 31.12.2002 të jenë shpenzuar plotësisht. Bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar tatimet, ndërkohë që në rastin konkret kursimet e realizuara nga puna ndër vite, si *cash*, ashtu edhe në formën e likuiditeteve në bankë, nuk janë deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë për vitin 2003. Për këtë arsye, nuk qëndron pretendimi i ngritur në ankim nga ana e tij.*

23.10 *Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, duke marrë në konsideratë vlerësimin ligjor të pretendimeve të parashtruara nga subjekti si më sipër në këtë vendim, rezultoi që subjekti i rivlerësimit, personat e lidhur me të dhe personat e tjerë të lidhur me të, kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për periudhën 1983-1998 për të krijuar pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 141 m²”, në vlerën 184.396 lekë, pa marrë në konsideratë në këtë analizë shpenzimet për*

⁵ *Shih paragrafin 1.17 të vendimit të Komisionit, si dhe tabelën nr. 2, faqe 12 të këtij vendimi; zërin “Shpenzime blerje apartamenti” në vlerën -1.655.960 lekë, e përlllogaritur si shumë e këstit të parë në vlerën 846.000 lekë me këstin e dytë, në vlerën 809.860,40 lekë, ku është konvertuar kësti i dytë prej 8460 USD me 95,74 lekë për 1 dollar amerikan (8460 USD x 95,74 ALL/USD).*

jetesë të bëra prej tyre gjatë periudhës së analizuar, në mungesë të të dhënave zyrtare për periudhën përkatëse.

Në përfundim, për këtë pasuri, pas analizimit të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit, personit të lidhur dhe personave të tjerë të lidhur me të, trupi gjykues në Kolegj e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas nenit 33, pika 5, germa "b" e këtij ligji.

24. Arsyetimi i mësipërm u bazua në aktet administruara si vijojnë.
- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 20.01.2017.
 - Kontratë porosie individuale e datës 05.02.1997, vërtetuar me vërtetimin nr. {***} rep., datë 07.02.1997, me porositës subjektin Fatos Qato dhe të porositur shoqërinë "{***}" ShPK.
 - Kontratë sipërmarrjeje e datës 09.01.1997, me palë investitore {***} dhe sipërmarrës shoqërinë "{***}" ShPK.
 - Mandatet nr. {***}, datë 15.01.1997 dhe nr. {***}, datë 08.12.1997 për pagimin e këstit të parë dhe të dytë të apartamentit.
 - Kontrata e shitjes përfundimtare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2017.
 - Shkresë e {***} nr. {***} prot., datë 22.02.2018, që konfirmon pronësinë e Fatos dhe M.Q. mbi këtë apartament.
 - Vërtetim nr. {***} prot., datë 09.11.2016, i {***}, në lidhje me të ardhurat neto nga paga, për periudhën 31.03.1983 - 29.04.1984, ku shpjegohet se {***} nuk disponon dokumentacion mbi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit.
 - Vërtetim, datë 24.01.2017, i {***}, për periudhën dhjetor 1986 - qershor 1992, ku informohet se nga ana e këtij institucioni nuk disponohet dokumentacion mbi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit gjatë kohës që kishte punuar si hetues në Hetuesinë e Rrethit Tiranë.
 - Vërtetim nr. {***} prot., datë 23.01.2017, i {***}, në lidhje me të ardhurat neto nga paga, për periudhën 01.04.1993 e në vijim, ku jepet informacion mbi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit.
 - Vërtetim nr. {***} prot., datë 25.10.2016, i {***}, i cili jep informacion në lidhje me të ardhurat e realizuara nga subjekti i rivlerësimit nga puna në këtë institucion për periudhën 1999-2001.
 - Vërtetim {***} prot., datë 26.10.2016, i {***}, në të cilin jepet informacion në lidhje me të ardhurat e realizuara nga znj. M.Q., nga puna në këtë institucion, për periudhat: maj 1997 - 30 gusht 2007 dhe për periudhën 04.11.2013 e në vijim.
 - Vërtetim nr. {***} prot., datë 25.11.2016, i përmbaruesit gjyqësor privat A.S., me anë të të cilit vërtetohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 19.06.2008, nëpërmjet të cilit M.Q. ka përfituar shumën 1822531 lekë.
 - Vërtetim i datës 20.01.2017, i Kolegjit Universitar "{***}", për të ardhurat e realizuara nga punësimi i znj. M.Q., pranë këtij institucioni, për periudhat 01.01.2006 - 31.12.2006; dhe 01.01.2007- 31.12.2007.

- Shkresë nr. {***} prot., datë 25.01.2019, nga {***}, me të cilën vërtetohet punësimi i znj. M.Q., për periudhën shtator 1990 - prill 1995, por nuk jepen të dhëna mbi të ardhurat e përfituara.
- Vërtetim nr. {***} prot., datë 13.01.2017, i {***}, në të cilin jepet informacion në lidhje me të ardhurat e realizuara nga znj. M.Q., nga puna në këtë institucion, për periudhat 2005-2008, 2010-2012 dhe vitet 2014 dhe 2015.
- Vërtetim nga {***}, nr. {***} prot., datë 20.01.2017, për znj. M.Sh., në të cilin jepen të dhëna për të ardhurat e përfituara, për periudhën gusht 1995 - shtator 1996.
- Vërtetime nga {***} nr. {***} dhe nr. {***}, datë 09.01.2017, për masën e pensionit të z. S.Sh. dhe të znj. V.Sh.
- Vërtetim i {***} nr. {***} prot., datë 04.12.2018, për znj. V.Sh.
- Vërtetim i {***} nr. {***} prot., datë 04.12.2018, për z. S.Sh.
- Shkresë e {***} nr. {***} prot., datë 08.02.2018, me anë të së cilës jepen të dhëna në lidhje me të ardhurat financiare bruto dhe neto të realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja.
- Vërtetim i {***} të Bashkisë Tiranë, me nr. {***} prot., datë 04.12.2018, që vërteton se familja e subjektit të rivlerësimit ka bashkëjetuar me prindërit e bashkëshortes që nga martesja e deri aktualisht (ditën e shkresës).
- Vërtetim i institutit “{***}” nr. {***}, datë 05.12.2018, që vërteton dhënien me qira nga znj. V.Sh. të objektit të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. {***}, me nr. {***}, datë 22.11.1995, me vlerë 1.200 USD në muaj, për periudhën 1995-1997.
- Përgjigjet e pyetësorëve të Komisionit.
- Deklarimet periodike të interesave privatë të pasurisë dhe deklarata e pasurisë *vetting* 2017.

V. Lidhur me pasurinë "tokë arë me sip. 410 m²", ndodhur në {***}, {***}, Pogradec

25. Komisioni në vendim, për këtë pasuri ka arritur në përfundimin se *subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e pasurisë “tokë arë”, si dhe për të përballuar shpenzimet e kryera në vitin 2012*. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë përfundim të Komisionit, duke argumentuar se llogaritjet e kryera nga Komisioni nuk janë të sakta, pasi nuk është marrë në konsideratë në këto përlllogaritje rezultati financiar për tepricën monetare pozitive që akumulohet dhe mbartet nga viti 2003 deri në vitin 2011, por i zeron ato duke e filluar llogaritjen e vitit 2012 me gjendje zero të mjeteve monetare.
26. Trupi gjykues i Kolegjit për pasurinë "tokë arë me sip. 410 m²", ndodhur në {***}, {***}, Pogradec, vlerëson se:
 - a. Shkresa e {***}, nr. {***} prot., datë 22.02.2018, konfirmon se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, M.Q. ka në pronësi të saj një tokë arë, me sipërfaqe 410 m² sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi dhe 420 m² sipas librit të ngastrave.
 - b. Pasuria “tokë arë” është deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave privatë për vitin 2011, ndërkohë që duhet të ishte deklaruar në deklaratën e vitit 2012, për shkak se kontrata e shitblerjes është e datës 28.02.2012. Për të verifikuar aftësinë paguese me burime nga të ardhura

të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, për blerjen e kësaj toke u krye analiza financiare për vitin 2012, sipas vlerësimit ligjor të dokumentacionit të administruar. Në të ardhurat e subjektit të rivlerësimit u morën në konsideratë të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes dhe vajzës së tij, si dhe të ardhurat nga pensionet e vjehrrit e vjehrrës së subjektit të rivlerësimit, të realizuara në vitin 2012.

c. Për të ardhurat nga dhurimet e vëllezërve dhe shokëve të subjektit të rivlerësimit për arsye shëndetësore, në vlerën 1.257.480 lekë⁶, të përlllogaritura në zërin “të ardhura”⁷ nga Komisioni në analizën financiare të kryer për vitin 2012, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti nuk i ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë për vitin 2012 në vlerat përkatëse, sipas deklaratave noteriale. Në këtë deklaratë subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as shpenzimet për kurimin e tij në Gjermani, në vlerën 6.500 euro. Në kuptim të nenit 4, germa “h” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, të ndryshuar, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ligjor të plotësonte saktë deklaratën e interesave privatë për vitin 2012, duke deklaruar si të ardhurat e pretenduara nga dhurimet, ashtu edhe shpenzimet për kurim të mbuluara me këto të ardhura. Trupi gjykues, ashtu sikurse Komisioni, arsyeton se mosdeklarimi i shpenzimeve për kurim nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë për vitin 2012, lidhet me mungesën e të ardhurave të ligjshme financiare për të mbuluar këto shpenzime dhe të tjera të kryera përgjatë këtij viti. Nga analiza financiare e kryer në Komision për vitin 2012, pasi u morën në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, edhe pse u përlllogaritën në zërin “të ardhura” dhurimet e pretenduara, përsëri u konstatua mungesa e të ardhurave nga burime financiare të ligjshme në vlerën 2.171.407 lekë.

ç. Sa u takon “shpenzimeve” të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të për vitin 2012, vlerësojmë se në këtë zë të analizës financiare duhet të merren në konsideratë:

- shpenzimet për konsum familjar sipas përlllogaritjeve të Komisionit, duke qenë se nuk janë paraqitur shkaqe ankimi;
- shpenzimet mjekësore janë konsideruar në vlerën 9.000 euro për vitin 2012, sikundër është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorin standard të datës 27.09.2018 të Komisionit;
- shpenzimet e udhëtimit sipas përlllogaritjeve të Komisionit, duke qenë se nuk janë paraqitur shkaqe ankimi;
- shpenzimet për arredim në analizën e kryer për periudhën 2003-2016, janë përlllogaritur në të njëjtën metodologji si edhe në Komision, duke marrë në konsideratë sa është deklaruar nga subjekti në përgjigjen e pyetjes nr. 11 të pyetësorit standard dhe në përgjigjen e pyetjes nr. 3 të pyetësorit për subjektin e rivlerësimit, protokolluar nga Komisioni me nr. {***} prot., datë 16.10.2018;
- shpenzimet e shkollimit të djalit të subjektit të rivlerësimit sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 22.10.2018, të institucionit arsimor “{***}” ShA;

⁶ Konvertuar me kursin e datës 31.12.2012, EUR = 139.72 ALL, të marrë nga “Arkivës së kurseve të këmbimit”, publikuar në faqen elektronike zyrtare të Bankës së Shqipërisë:

https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/

⁷ Referoju tabelës nr. 4, në vijim të paragrafit 2.19, faqe 16 të vendimit nr. 87, datë 17.12.2018

▪ shpenzimet për interesa të paguar për qiratë financiare *leasing*, financiar subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes nga “{***}” ShA, me kontratë qiraje financiare nr. {***}, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.11.2010⁸, si dhe nga “{***}” ShA, me kontratë qiraje financiare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.08.2012⁹.

27. Në përfundim, për këtë pasuri, referuar analizës financiare të kryer për vitin 2012, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, personat e lidhur me të dhe personat e tjerë të lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 2.130.716 lekë për të blerë pasuritë “tokë arë, me sipërfaqe 410 m²” dhe autoveturë tip “Renault Koleos”, si dhe për të realizuar shpenzimet e kryera në vitin 2012, si: pagesën e detyrimeve financiare (principal + interesa) për qiranë financiare *leasing* të financiar nga “{***}” ShA, interesat e paguar për qiranë financiare *leasing* të financiar nga “{***}” ShA, shpenzimet për konsum familjar, shpenzimet mjekësore, shpenzimet e shkollimit të djalit të subjektit të rivlerësimit, shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e arredimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.

28. Arsyetimi i mësipërm u bazua në aktet e administruara si vijojnë.

▪ Shkresë nr. {***} prot., datë 22.02.2018, e {***}, sipas së cilës M.Q. ka të regjistruar në pronësi një sipërfaqe “tokë arë” 410 m², sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi dhe 420 m² sipas Librit të Ngastrave.

▪ Certifikatë pronësie nr. {***}, datë 05.01.2012, për pasurinë “tokë arë, me sipërfaqe 410 m²”, me nr. {***} pasurie, në {***}, vol. {***}, faqe {***}, në emër të shitësve Ll.B. etj.

▪ Kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.02.2012, për blerjen e pasurisë “tokë arë me sipërfaqe 410 m²”, me shitës Ll.B., i cili është edhe përfaqësues me prokurë i disa bashkëpronarëve, si dhe palë blerëse M.Q., në vlerën 108.363 lekë.

▪ Shkresë e shoqërisë “{***}” ShA, me nr. {***} prot., datë 09.02.2018, që konfirmon kontratën e qirasë financiare ndërmjet kësaj shoqërie dhe znj. M.Q., për blerjen e një automjeti të markës “Volkswagen”, sipas kontratës së qirasë financiare nr. {***} prot., datë 30.11.2010.

▪ Shkresë e shoqërisë “{***}” ShA, me nr. {***} prot., datë 20.02.2018, që konfirmon kontratën e qirasë financiare ndërmjet kësaj shoqërie dhe Fatos e M.Q., për blerjen e një automjeti të markës “Renault Koleos”, sipas kontratës nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 02.08.2012.

▪ Vërtetimet e të ardhurave, si paraqitur në paragrafin nr. 24 të këtij vendimi.

⁸ Kontratë qiraje financiare nr. {***}, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.11.2010, me objekt autoveturë, tip “Volkswagen Polo”, me çmim blerjeje (përfshirë TVSh) në vlerën 15.500 euro, parapaguar 7.300 euro (47,1% e çmimit të blerjes), shuma e financiar 8.200 euro (52,90% e çmimit të blerjes), 124 euro komision administrimi, afati 36 muaj, interesi: EURIBOR me maturim 6 muaj + 7,5% (spread).

⁹ Kontratë qiraje financiare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.08.2012, me objekt autoveturë, tip “Renault Koleos”, në vlerën 28.500 euro, paguar 35% (10.000 euro) nga subjekti, ndërsa diferenca 18.500 euro, paguar me këste, me afat maturimi 20.07.2017, me interes: EURIBOR me maturim 12 muaj + 5% në vit (spread), por jo më pak se 8,5% në vit.

- Shkresa e {***} nr. {***} prot., datë 26.09.2018, në lidhje me udhëtimet për shkak të detyrës së subjektit të rivlerësimit.
- Shkresa e {***}-së, nr. {***} prot., datë 04.10.2018, në lidhje me udhëtimet për shkak të detyrës së bashkëshortes të subjektit, znj. M.Q.
- Deklarata noteriale nga z. P.Q., z. A.Q. dhe z. H.B., që vërtetojnë dhënien shumave 500 euro secili për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të subjektit në vitin 2012.
- Përgjigjet e subjektit ndaj pyetësorit standard të Komisionit për subjektin e rivlerësimit, të datës 12.02.2018, përgjigjet e pyetësorit të datës 27.09.2018, përgjigjet e pyetësorit të datës 16.10.2018, si dhe përgjigjet e pyetësorit të datës 26.10.2018.
- Shpjegimet ndaj rezultateve të hetimit në Komision dhe deklaratimet e subjektit në seancë dëgjimore pranë Komisionit.

VI. Analiza financiare përfundimtare e kryer nga Komisioni për vitet 2003-2016

29. Komisioni në vendim, pas analizës financiare të kryer për vitet 2003-2016, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë dhe për të mbuluar shpenzimet ndër vite me të ardhura nga burime të ligjshme. Subjekti i rivlerësimit për këtë konkluzion ka ngritur pretendimet e mëposhtme.
- Komisioni nuk duhet të llogariste shpenzimet për arredim në vlerën 25.000 euro ose 2,7 milionë lekë, por duhet t'i shpërndante ato ndër vite, duke filluar nga viti 1990 deri në vitin 2016, që përputhet me përgjigjet e dhëna prej tij në pyetësorët përkatës (1,5 milionë për periudhën 1990-2002 dhe 1,2 milionë për periudhën 2003-2016).
 - Kundërshton konstatimin e Komisionit se nuk ka paraqitur dokumentacion provues për dhënien e shumës në vlerën 5.000 euro nga prindërit e bashkëshortes për blerjen e një këndi ndenjjeje për shtëpinë, si dhe për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj shume. Sipas subjektit, shuma e sipërcituar nuk është “dhënë” nga prindërit e bashkëshortes pasi ata jetonin në një ekonomi të përbashkët familjare dhe të ardhurat nga pensionet kanë shërbyer për blerjen e këtij objekti/sendit.
 - Në vitet që rezultojnë me gjendje negative, teprica e çdo viti ushtrimor duhet t'i shtohet vitit pasues negativ dhe diferenca progresive është periodikisht pozitive, çfarë tregon se çdo vit ekzistojnë burime të mjaftueshme financiare. Komisioni ka gabuar kur merr në konsideratë vetëm vlerat negative të viteve, ndërsa të gjitha vitet e tjera që janë me vlera pozitive, i zeron.
 - Është i gabuar përfundimi i Komisionit se subjekti nuk provoi me dokumentacion burimet e ligjshme të përdorura për kurimin në Gjermani në vlerën 6.500 euro, pasi ka depozituar deklarata noteriale, ka shpjeguar hollësisht në pyetësor burimin e këtyre të ardhurave dhe ka pasur burime financiare të ligjshme për përballimin e shpenzimeve të kryera në këtë vit, përfshirë edhe shpenzimet mjekësore.

- Kundërshton konstatimin e Komisionit pas kryerjes së analizës financiare për vitet 2014 dhe 2015 se ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të mbuluar shpenzimet e shkollimit të fëmijëve pasi, sipas analizës financiare të kryer prej tij për periudhën 2003-2016, ka rezultuar se çdo vit ka pasur teprica pozitive monetare, përfshirë edhe vitet e sipërcituara.

30. Lidhur me pretendimet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson sa vijon.

a. Subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor në përgjigjet e pyetësorëve në Komision, si dhe në shpjegimet e dhëna për rezultatet e hetimit administrativ, kaluar atij si barrë prove, lidhur me shpenzimet për arredim në vlerën 25.000 euro ose 2,7 milionë lekë. Subjekti i rivlerësimit është pyetur në pyetësorin standard në Komision mbi vlerën e arredimit të shtëpisë/ve të tij. Gjithashtu i është kërkuar të specifikojë natyrën dhe kostot e çdo arredimi që tejkalon shumën 2.500 euro. Subjekti i rivlerësimit është përgjigjur: “Vlera e arredimit të shtëpisë në total: 25.000 euro. Rinovim kemi bërë vetëm në këndin e kolltukëve në ambientin e ndenjjes, në vlerën 5.000 euro [...]”.

Në pyetësorin e datës 27.09.2018, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të shpjegojë periudhën se kur është bërë ky arredim. Subjekti i rivlerësimit është përgjigjur: “Arredimi i shtëpisë ku unë banoj, ka filluar përpara vitit 2005, vit kur na është dhuruar ndërtesa, pasi ne kemi jetuar në atë shtëpi që nga momenti i ndërtimit dhe i regjistrimit, që përkon me vitin 1995”. Ndërsa në shpjegimet për rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit sqaron se: “Arredimi i shtëpisë është bërë për një periudhë prej 28 vitesh, që nga data e martesës deri më sot [...], janë bërë arredime në vijimësi [...], ndër vite, nga pjesëtarët e familjes”.

Në shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorin e datës 16.10.2018, ku i është kërkuar nga Komisioni të deklarojë vlerën e arredimit të apartamentit të ndodhur në rr. “{***}” dhe vlerat përkatëse të shpenzimeve të arredimit të kryera prej tij për secilin vit, subjekti ka deklaruar për këtë apartament se “[...] nuk është bërë asnjë shpenzim arredimi”, pasi për mobilimin e tij janë përdorur mobiliet e banesës/vilës në rr. “{***}”.

Në pikën 3 (tre) të pyetësorit të mësipërm, Komisioni i ka kërkuar të specifikojë për secilin vit vlerat përkatëse të shpenzimeve të kryera për arredimin e banesës së ndodhur në rr. “{***}”. Subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur pyetjes: “[...] shpenzimet për arredim apo për ndonjë kërkesë bazë jetësore familjare kanë qenë kryesisht shumat e kursyera në vitin respektiv paraardhës, pra në fund të vitit 2005 kam pasur kursime *cash* 600.000 lekë, të cilat i kam shpenzuar për arsyet e mësipërme në vitin 2006. Në vitin 2007, kemi shpenzuar për arsyet e mësipërme kursimet e vitit 2006. Për vitin 2007, kemi shpenzuar për arsyet e mësipërme kursimet e vitit 2006. Në vitin 2008, kemi shpenzuar për arsyet në fjalë kursimet e vitit 2007. Në vitin 2009, kemi shpenzuar për arsyet në fjalë kursimet e vitit 2008. Në vitin 2010, kemi shpenzuar kursimet e vitit 2009 dhe në vitin 2012, kemi shpenzuar kursimet e vitit 2011. Këtyre shpenzimeve për arredim i shtohet edhe vlera e këndit të blerë nga prindërit e bashkëshortes”.

Komisioni, bazuar në deklaratimet e interesave privatë/periodikë vjetorë ndër vite të subjektit të rivlerësimit, ka konstatuar se gjendja e akumuluar e likuiditeteve në *cash* të subjektit të rivlerësimit

dhe të personave të lidhur me të në fund të vitit 2016, duhet të ishte 2.095.450 lekë, ndërkohë që në deklaratën *vetting* subjekti nuk ka deklaruar të ketë pasur gjendje likuiditetesh në *cash*. I pyetur për këtë diferencë të gjendjes së likuiditeteve në *cash* sipas deklarimeve periodike dhe sipas deklaratës *vetting*, subjekti ka sqaruar se “në kohën e dorëzimit të deklaratës *vetting*, nuk disponoja gjendje *cash* të lekëve, pasi shumë 2.095.450 lekë të kursyer deri në vitin 2011, e kam përdorur një pjesë për arredimin e shtëpisë dhe pjesën tjetër të lekëve për shpenzimet e viteve pasardhëse, kryesisht shkollimin e fëmijëve”.

Nga shqyrtimi i analizës financiare të kryer nga Komisioni, rezulton se përlllogaritja e shpenzimeve të arredimit është shpërndarë jo në 5 (pesë) vitet e fundit, siç pretendon subjekti në ankim, por nga viti 2006 deri në vitin 2012, duke përfshirë vitin 2011 për të cilin në deklaratën e interesave privatë nuk ka deklaruar gjendje *cash*.

Në përmbledhje të analizës së kryer më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të arredimit nga ana e Komisionit.

b. Në kushtet kur prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit kanë bashkëjetuar gjatë gjithë kohës me familjen e tij dhe të ardhurat nga pensionet e tyre janë konsideruar në të ardhurat e familjes nga burime të ligjshme për periudhën 2003-2016, sipas trupit gjykues, vlera 5.000 euro për blerjen e një këndi ndenjeje për shtëpinë në shtator të vitit 2016, e deklaruar në pyetësonin standard të Komisionit të datës 12.02.2018, duhet të përlllogaritet si shpenzim i kryer në kuadër të ekonomisë së përbashkët familjare.

Trupi gjykues i Kolegjit vëren se të ardhurat nga pensionet e prindërve të bashkëshortes janë përlllogaritur në analizën financiare¹⁰ të kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016. Në analizën financiare të kryer për vitin 2016, vlera 5.000 euro, ose 676.350 lekë, është përfshirë në zërin e shpenzimeve “arredim financiar nga vjehrra”. Në këtë kuptim, trupi gjykues çmoi të nevojshme kryerjen e analizës financiare për periudhën 2003-2016, në kuadër të regjimit të përbashkët familjar të subjektit të rivlerësimit, të personave të lidhur dhe të personave të tjerë të lidhur me të, duke përfshirë në të ardhura të ligjshme pagat e subjektit, të bashkëshortes, të vajzave të tij dhe të ardhura të tjera të provuara me dokumentacion justifikues ligjor, si dhe të ardhurat nga pensionet e prindërve të bashkëshortes. Në këtë zë të analizës financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e deklaruara në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë, të përfituara nga dhënia me qira e apartamentit në rr. “{***}” për vitet 2007 dhe 2012-2014, në kushtet kur nga organet tatimore është konfirmuar se nuk ishte paguar tatimi mbi të ardhurat e realizuara nga qiraja në këto vite. Këto të ardhura konsiderohen të paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në zërin “shpenzime” janë përlllogaritur të gjitha shpenzimet e kryera nga të gjithë anëtarët e familjes, bazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioni.

Nga analiza financiare e kryer, trupit gjykues të Kolegjit i rezultoi që subjekti i rivlerësimit, personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur me të kanë pasur mundësi që, me të ardhurat e

¹⁰ Referoju paragrafit 1.16 të vendimit nr. 87, datë 17.12.2018, të Komisionit.

ligjshme të përfituara në vitin 2016, të realizojnë shpenzimet për pagesën e qirasë financiare *leasing* në “{***}” ShA, për konsum familjar, për udhëtime, për arredim, për shkollimin e të bijës dhe të djalit të tij dhe për pasurinë e krijuar në këtë vit

31. Diferencat negative të rezultuara në fund të vitit nga përlllogaritjet në kuadër të analizës financiare të kryer për periudhën e rivlerësimit 2003-2016, tregojnë pamjaftueshmëri të të ardhurave nga burime financiare të ligjshme të subjektit për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në vitin përkatës, përfshirë në pasuri edhe kursimet e deklaruara *cash* apo gjendje në llogari.

Totali i diferencave negative të rezultuara nga përlllogaritjet, përbën pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare të subjektit për të gjithë periudhën e rivlerësimit 2003-2016. Referuar nenit 4, pika “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003¹¹, i ndryshuar, sipas të cilit subjektet detyrohen të deklarojnë “vlerën e likuiditeteve, gjendjen në *cash* jashtë sistemit bankar në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, përveç ndryshimeve të ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë¹², duhet të deklaronte saktë edhe gjendjen e kursimeve në formë likuiditetesh *cash* apo në bankë në fund të çdo viti, prej vitit 2003 e në vazhdim. Bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar tatimet.

Në këtë këndvështrim, nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhënë pyetjes/pikës 3 (tre) të pyetësorit të datës 16.10.2018 të Komisionit, ka deklaruar “[...] shpenzimet për arredim apo ndonjë kërkesë bazë jetësore familjare kanë qenë kryesisht shumat e kursyera në vitin paraardhës”, trupi gjykues konstaton që kursimet e deklaruara se janë përdorur për shpenzime nga subjekti në vitin pasardhës, janë përfshirë faktikisht në analizën e kryer. Nga arsyetimi i mësipërm, vlerësojmë se pretendimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me mbartjen e tepricave pozitive në vitet kur ato kanë rezultuar negative, në kuadër të analizës financiare përfundimtare të kryer në Komision, nuk qëndron, pasi është e pamundur që ai të ketë shfrytëzuar këto teprica për të përballuar shpenzimet e viteve të mëparshme. Nga përlllogaritjet e kryera në Kolegj, bazuar në analizën ligjore si më sipër në këtë vendim, edhe teprica progresive rezulton negative dhe jo pozitive, siç pretendon subjekti i rivlerësimit në ankim.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i deklaratës *vetting* dhe i deklaratës së interesave privatë për vitin 2012, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shpenzimet për kurim në Gjermani, në vlerën 6.500 euro, të kryera në vitin 2012, si dhe dhurimet e bëra në këtë vit nga të afërm dhe shokë të subjektit në vlerat përkatëse, sipas deklaratave noteriale të depozituara prej tij. Trupi gjykues vlerëson se deklaratat noteriale, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, janë

¹¹ Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, me ligjin nr. 9475, datë 09.02.2006, me ligjin nr. 9529, datë 11.05.2006, me ligjin nr. 85/2012, datë 18.09.2012, si dhe me ligjin nr. 45/2014, datë 24.04.2014.

¹² Sipas nenit 7, pika 1 e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.

jobindëse dhe bien ndesh me deklaratën e interesave privatë të vitit 2012, referuar arsyetimit të shprehur në paragrafin 26.3 të vendimit të Komisionit.

32. Lidhur me shpenzimet për shkollim të fëmijëve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pas shqyrtimit dhe analizimit të deklaratave të interesave privatë periodikë vjetorë, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shpenzimet për shkollimin e vajzës E.Q., në vlerën 12000 euro, në deklaratën e interesave privatë për vitin 2014¹³, si dhe shpenzimet për shkollimin e djalit pranë institucioni arsimor “{***}” ShA, në vlerën 3925 euro, 3175 euro dhe 5328 euro, përkatësisht në vitet 2014, 2015 dhe 2017. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2014, ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 1.492.874 lekë. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mungesës së të ardhurave të ligjshme për të kryer shpenzimet e shkollimit për vitin 2014.
33. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit e parashtrimet e subjektit në ankim dhe pasi shqyrtoi provat e administruara në këtë çështje, arrin në përfundimin se:
 - i. Për pasurinë "apartament me sipërfaqe 141 m², ndodhur në rr. "{***}", p. {***}, ap. {***}, Tiranë", subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.
 - ii. Për pasurinë “tokë arë, me sip. 410 m²”, me vlerë 108.363 lekë, ndodhur në {***}, {***}, Pogradec, blerë nga bashkëshortja M.Q., me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.02.2012, ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.
 - iii. Rezultatet e analizës financiare të kryer në Kolegj për periudhën 2003-2016, bazuar në provat e administruara dhe deklaratimet e subjektit, tregojnë se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe për të justifikuar shpenzimet mjekësore, për shkollimin e fëmijëve, për arredim, për udhëtime jashtë vendit, si dhe për shpenzime për konsum familjar, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

¹³ Referuar vërtetimit të dërguar nga Universiteti {***}, më 05.01.2017, përkthyer nga znj. A.S., vërtetuar me vërtetim nënshkrimi nr. {***} prot., datë 05.11.2018, nga notere E.M., tarifa e studimit për vitin shkollor 2014-2015 ka qenë 12.000 euro, e paguar tërësisht më 09.09.2014, ndërsa sipas deklaratimit të subjektit në përgjigjen e pyetjes nr. 5 të pyetësorit të datës 27.09.2018, shpenzimet e jetesës së vajzës për periudhën shtator – dhjetor 2014 kanë qenë 1.000 euro, për periudhën janar – gusht 2015 kanë qenë 1.000 euro dhe prej muajit gusht e në vijim, sipas deklaratimit të subjektit në të njëjtin pyetësor, “[...] është në marrëdhënie pune dhe vetëfinancohet”.

Me dokumentacion bankar, vërtetohet pagesa e këstit të parë dhe të dytë të tarifës studimore për {***}, Holandë, për vajzën e dytë të subjektit, K.Q., në vlerat 3.584 euro dhe 3.560 euro përkatësisht.

Me vërtetimin nr. {***} prot., datë 22.10.2018, institucioni arsimor “{***}” ShA vërteton se kostot financiare të edukimit për vitin 2010 kanë qenë 500 euro, për vitin 2011 kanë qenë 2.895 euro, për vitet 2012 dhe 2013 kanë qenë 2.925 euro, për vitin 2014 kanë qenë 3.925 euro, për vitin 2015 kanë qenë 3.175 euro dhe për vitin 2016 kanë qenë 1.900 euro.

iv. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

34. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, në mbështetje të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerëson se vendimi nr. 87, datë 17.12.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 87, datë 17.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Fatos Qato.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 08.11.2019.

GJYQTAR
Ardian Hajdari

nënshkrimi

GJYQTAR
Luan Daci

nënshkrimi

GJYQTARE
Rezarta Schuetz

nënshkrimi

RELATORE
Natasha Mulaj

nënshkrimi

KRYESUESE
Ina Rama

nënshkrimi